

RREGULLORE PER MARKAT

I. TE PERGJITHSHME

1.Perkufizime

Regulli-1 Perkufizimi i markes tregtare.

Ne perputhje me ligjin Nr.7819 date 27.04.1994 “Per pronesine Industriale” (ne vijim do te quhet “Ligji”) termi “marke tregtare” perfshin çdo fjale dalluese , emer, simbol, embleme, shenje ose devize, kombinime te ngjyrave ose nuancave te tyre, ose çdo kombinim I elementeve te mesiperm I pershtatur dhe I perdorur nga nje person fizik ose juridik ne mallrat e tij per te identifikuar dhe dalluar keto mallra nga ato te nje personi tjeter fizik ose juridik.

Rregulli-2 Perkufizimi i markes se sherbimit.

Ne perputhje me Ligjin termi “marke sherbimi” do te thote nje marke e perdorur ne shitjen dhe reklamimin e sherbimeve per te identifikuar sherbimet e nje personi fizik ose juridik dhe per t’i dalluar ato nga sherbimet e personave te tjere fizike ose juridike dhe perfshin marka, emra, simbole, tituj, parrulla, shenja figurative, kombinime te ngjyrave ose te nuancave te tyre ose kombinime te elementeve te mesiperm.

Rregulli-3 Perkufizimi i markes kolektive.

Ne perputhje me Ligjin “marke kolektive” eshte nje marke e perdorur nga anetaret e nje shoqate, grupi kolektiv ose organizate.

2. Cfar kerkohet per regjistrim

Rregulli-4 Prane Zyres se Patentave paraqitet kerkesa per regjistrimin e markave tregtare, markave te sherbimit dhe markave kolektive.

3.Kush paraqet kerkese per regjistrim

Rregulli-5 Vetem pronari i markes tregtare, te markes se sherbimit dhe asaj kolektive mund te beje kerkese per regjistrimin e saj.

Rregulli-6 Cdo person fizik ose juridik i cili prodhon ose tregon mallrat e cdo lloji, ose qe kryen sherbime ne tregeti, nga perdorimi aktual ne prodhim ose ne tregeti dhe ne kryerjen e sherbimeve mund te percaktoje per perdorim ekskluziv nje marke tregtare ose sherbimi, jo ne pronesine e te tjereve, per te dalluar mallrat ose sherbimet e tij nga ato te te tjereve.

Rregulli-7 Kolektivat mund te bejne kerkese per regjistrimin e nje marke kolektive edhe ne qofte se ata nuk kane ne pronesi nje ndermarrje industriale, tregtare.

4. Korrespondenca

Rregulli-8 Te gjitha çeshtjet ne Zyren e Patentave ne lidhje me market dhe kerkesat per regjistrimin e tyre trajtohen me shkrim. Veprimet e zyres do te bazohen ekskluzivisht ne shenimet e shkruara. Nuk do te merret parasysh asnje deshmi, kusht ose shpjegim per ate qe eshte e dyshimte ose ne mospajtim me Ligjin dhe rregulloren e Zyres se Patentave, ne rastin kur keto behen gojarisht.

5. Tarifat

Rregulli-9 Te gjitha terifat qe duhet t’i paguhen Zyres se Patentave ne lidhje me kerkesat per regjistrimin e markave ose markat, paguhen ne avance per çdo sherbim qe do te kryhet nga ana e saj.

Rregulli-10 Tarifat per market tregetare sipas V.K.M. nr. 379 date 15.08.1994 “Tarifat e Zyres se Patentave per Objektet e Pronesise Industriale”, jane te paraqitura ne pasqyrat e meposhteme:

Nr.	Lloji I Tarifes	Njesia	Per personin fizik e juridik vendas dhe te huaj
1	Tarifa per depozitimin e kerkeses per marka individuale	Leke	4500
2	Tarifa per depozitimin e kerkeses per marke kolektive	Leke	6000
3	Tarifa per çdo klase shtese te mallrave dhe sherbimeve	Leke	2500
4	Tarifa per depozitimin e çdo kerkeses te ndare	Leke	2500
5	Tarifa per regjistrimin e markes tregetare (Dhenia e çertifikates)		Leke
6000			
6	Tarifa per Apelim ne Bordin e Apelimit te Zyres se Patentave.		Leke
7000			
7	Tarifa e regjistrimit te kontrates per license ne Regjistrin e Markave.		Leke
3500			
8	Tarifa e perteritjes se markes individuale (per 10 vjet)	Leke	7000
9	Tarifa e perteritjes se markes kolektive (per 10 vjet)	Leke	9000
10	Tarifa e perteritjes se regjistrimit per çdo klase shtese te mallrave dhe sherbimeve		Leke
4000			

Nr	Lloji I Tarifes	Per personat fizik vendas	P e r
	personat e huaj dhe juridike vendas		

Nr.	Lloji I Tarifes	Njesia	Vlera e Tarifes	Vlera e Tarifes
1	Tarifa per dhenien e deshmise se prioritetit	Leke	1500	1500
2	Tarifa per dhenien e ekstrakteve nga dosjet e markave dhe regjistri I Markave (per çdo faqe format A4)	Leke	100	200
3	Tarifa per inspektimin e dosjeve	Leke	150	150
4	Tarifa per regjistrimin e ndryshimeve ne lidhje me emrin, adresen, pronesine dhe te tjera te kesaj natyre.	Leke	1500	2500
5	Tarifa e leshimit te dublikateve te çertifikateve per marka te regjistruar ne regjistrin e Markave	Leke	1000	1000
6	Tarifa per dhenie te informacionit per markat e vlefshme: Brenda Republikes se Shqiperise Jashte Republikes se Shqiperise	Leke	3001200	3001200

II. Regjistrimi ne Regjistrin e Markave

1. Pranimi i kerkeses per regjistrim

Rregulli-11 Kerkesa per regjistrim marke behet sipas formularit F01/94M qe jepet pa pagese dhe nenshkruhet nga paraqitesi I kerkeses. Ajo nuk mund te nenshkruhet nga perfaqesuesi ose nga perfaqesuesi I autorizuar I patentave. Nje kerkeses behet per regjistrimin e nje marke te vetme persa I perket mallrave ose sherbimeve qe I takojne nje ose me shume klasave te Klasifikimit Nderkombetar te mallrave te Sherbimeve.

Rregulli-12 Formulari F01/94M dergohet ne 2(dy) kopje ne Zyren e Patentave me poste, dorazi ose me faks nga paraqitesi I kerkeses ose perfaqesuesi I autorizuar I patentave. Ne rastin e degimit me faks, paraqitesi I kerkeses duhet qe Brenda nje muaji nga data e dergimit te faksit te dergoje ne Zyren e Patentave kerkesen ne formen e saj origjinale. Ne rast te kundert kerkesa e derguar nepermjet faksit konsiderohet si e paparaqitur ne Zyren e Patentave.

Rregulli-13 Diten qe kerkesa e paraqitur ne Zyren e Patentave, ekzaminuesi shenon ne formularin F11/94M daten dhe oren e paraqitjes se kerkeses dhe numrin e kerkeses. Ai njofton paraqitesin e kerkeses nepermjet formularit F11/94M per numrin dhe llojin e dokumentave te marra nga Zyra e Patentave, numrin e kerkeses, daten dhe oren e marrjes se tyre.

Ekzaminuesi hap nje dosje te veçante per çdo marke ne te cilen vendoset I gjithë dokuemntacioni qe pasqyron proceduren per trajtimin e kerkeses per regjistrimin e nje marke.

Rregulli-14 Ne perputhje me Nenin 78 te Ligjit nje kerkese per regjistrim marke permban:

- a) emrin, adresen dhe nenshtetesine e paraqitesit te kerkeses;
- b) te dhenat lidhur me perfaqesuesin ne qofte se ka te tille ne perputhje me Nenin 98 te Ligjit dhe autorizimin e perfaqesimit;
- c) emrin e perfaqesuesit te autorizuar te patentave dhe numrin e regjistrimit te tij ne Rregjistrin perkates dhe autorizimin e perfaqesimit;
- d) riprodhimin e markes se kerkuar per regjistrim si dhe 3 (tre) pamje te tjera identike me ate qe vendoset ne formularin F01/94M;
- e) dokumentin qe verteton pagesen e tarifes se caktuar;
- f) ne rastin kur pretendohet per prioritet, deshmine e prioritetit te leshuar nga Zyra perkatese ose çertifikaten e leshuar nga autoritetet kompetente te ekspozites ku jane paraqitur mallrat dhe/ose sherbimet per te cilat kerkohet regjistrimi I markes;
- g) ne rastin kur marka eshte kolektive, rregullat e perdorimit te markes;
- h) lista e mallrave dhe/ose sherbimeve per te cilat kerkohet regjistrimi I markes te klasifikuar sipas Klasifikimit Nderkombetar te Mallrave dhe Sherbimeve.

Rregulli-15 Brenda 1 (nje) muaji nga data e njoftimit te paraqitesit te kerkeses nepermjet formularit F11/94M, lidhur me marrjen ne dorezim te dokumentave te derguara, ai duhet te paraqese, ne qofte se nuk I jane bashkangjitur tashme kerkeses, autorizimin e perfaqesimit te perfaqesuesit ose te perfaqesuesit te autorizuar si dhe deshmine e prioritetit te leshuar nga zyra perkatese ose nga autoritetet kompetente te ekspozites. Ne rast te kundert do te percaktohet si date depozitimi data e plotesimit te dokumentacionit nga paraqitesi I kerkeses.

Rregulli-16 Kerkesa dhe materialet e tjera qe I bashkangjiten asaj do te jene ne gjuhen shqipe. Ato duhet te dorezohen ne Zyren e Patentave te shtypura.

Rregulli-17 Riprodhimi I markes eshte nje fotografi e saj, e cila vendoset ne formularin F01/94M, Brenda kuadratit te caktuar per kete qellim. Tre pamjet e tjera qe I bashkangjiten formularit F01/94M duhet te jene identike me ate qe vendoset ne formularin F01/94M. Ne qofte se ekzaminuesi e konsideron te papershtatshem ndonje riprodhim te markes, ai mund te kerkoje nga paraqitesi I kerkeses nje riprodhim te pershtatshem. Ne qofte se riprodhimi nuk mund te behet sipas menyres se kerkuar nga ekzaminuesi, duhet te dergohet nje moster ose kopje e markes ose ne masen e plote te saj ose ne shkalle te zvogeluar.

Rregulli-18 Deshmia e prioritetit duhet te permbaje:

- a) daten e depozitimit te kerkeses me te hershme;

- b) numrin e kerkeses me te hershme; Zyren ne te cilen kerkesa me e hershme eshte depozituar.

Rregulli -24 Zyra e Patentave ben publikimin e kerkeses se depozituar brenda nje periudhe 1 (nje) mujore nga data e njoftimit te paraqitesit te kerkeses lidhur me depozitim e kerkeses. Publikimi perfshin:

- a) daten e depozitimit;
- b) riprodhimin e markes;
- c) listen e mallrave dhe/ose sherbimeve per te cilat eshte kerkuar regjistrimi I markes si dhe nje tregues I klases ose I klasave sipas Klasifikimit Nderkombetar te Mallrave dhe Sherbimeve.
- d) Emir dhe adresa e paraqitesit te kerkeses.

4. Shqyrtimi i kerkeses per regjistrim

Rregulli -25 Kerketat e depozituara shqyrtohen me rradhe sipas numrit te kerkeses te percaktuar ne formularin e kerkeses (F01/94M). Asnje kerkese me numer me te madh se te tjerat nuk do te shqyrtohet perpara kerkeses me numer me te vogel, perveç rasteve kur urdherohet me shkrim nga Drejtori i Zyres se Patentave.

Rregulli -26 Shqyrtimi i kerkeses behet Brenda periudhes 5 (pese) mujore nga data e depozitimit te saj. Brenda kesaj periudhe egzaminuesi shqyrton nese kerkesa eshte konform nenit 73 (3)(4) dhe 75 (2)(a)(b)(c) te Ligjit.

Rregulli -27 Shenjat qe i referohen nenparagrafit (2)(a) te nenit 75 te Ligjit mund te perfshihen si elemente te pambrojtur te markes . Ne kete rast paraqitesi I kerkeses duhet te sjelle dokumentin e leshuar nga autoritetet kompetente, qe verteton lejimin e perdorimit te ketyre elementeve ne marken qe kerkohet te regjistrohet.

Rregulli -28 Ne qofte se gjate shqyrtimit te kerkeses lind nevoja per dokumenta shtese, paraqitesi I kerkeses njoftohet me shkrim nepermjet formularit F05/94M. Paraqitesi I kerkeses duhet te paraqese prane Zyres, dokumentat e kerkuara, brenda nje periudhe 2 (dy) mujore nga data e njoftimit. Ne qofte se dokumentat nuk paraqiten Brenda periudhes se caktuar ose ato nuk jane te plota, kerkesa refuzohet perfundimisht dhe paraqitesi I kerkeses njoftohet per kete me shkrim nepermjet formularit F08/94M I cili firmoset nga egzaminuesi. Ne kete formular egzaminuesi paraqet dhe arsyet e refuzimit te kerkeses.

Rregulli -29 Ne qofte se egzaminuesi do te vendose per regjistrimin e markes, ai njofton per kete me shkrim paraqitesin e kerkeses dhe I kerkon atij qe brenda nje muaji nga data e njoftimit te beje pagesen e tarifes se regjistrimit ne Zyren e Patentave. Njoftimi behet nepermjet formularit F06/94M I cili firmoset nga egzaminuesi.

Rregulli -30 Egzaminuesi percakton numrin e regjistrimit dhe daten e regjistrimit te kerkeses dhe leshon çertifikaten e regjistrimit (formular F07/94M). Certifikata e regjistrimit permban:

- a) numrin e regjistrimit te markes;
- b) daten e regjistrimit
- c) listen e mallrave dhe/ose te sherbimeve per te cilat eshte regjistruar marka dhe treguesin e klases ose te klasave;
- d) numrin e kerkeses
- e) numrin e referimit te pjeses B te Regjistrimit te Markave;
- f) emrin e pronarit te markes se regjistruar

Certifikata firmoset nga Drejtori I Zyres se Patentave.

Rregulla-31: Zyra publikon marken e regjistruar Brenda nje periudhe 1 (nje) mujore pasi ka konfirmuar kryerjen e pageses se tarifes se regjistrimit. Publikimi perfshin:

- a) nje riprodhim te markes se regjistruar;
- b) numrin e regjistrimit;
- c) daten e regjistrimit;
- d) daten e depozitimit;
- e) emrin e pronarit te markes se regjistruar;
- f) listen e mallrave dhe/ose te sherbimeve per te cilat eshte regjistruar marka dhe nje tregues te klases ose te klasave.

Rregulli-32 Per çdo rast, te regjistrimit ose te refuzimit te kerkeses, egzaminuesi harton nje raport mbi rezultatet e shqyrtimit te kerkeses I cili vendoset ne dosjen perkatese te çdo marke.

Rregulli-33 Ne perputhje me Ligjin, regjistrimi I markes ne regjistrin e Markave eshte ne fuqi per 10 (dhjete) vjet nga data e depozitimit te saj, me perjashtim te rasteve kur hiqet dore nga regjistrimi I markes para mbarimit te afatit prej 10 vjetesh, kur zhvleresohet ose shfuqizohet.

5. Regjistri i markave

Rregulli-34 Zyra e Patentave mban Regjistrin e Markave, ne te cilin shenohen te dhena lidhur me marken e regjistruar. Regjistri eshte I hapur per inspektim per çdo person te interesuar, kundrejt pageses se tarifes perkatese. Zyra e Patentave jep ekstrakte nga Regjistri I Markave per çdo person te interesuar, kundrejt pageses se tarifes se caktuar.

Rregulli-35 Regjistri I Markave permban:

- a) perfaqesimin e markes;
- b) Te dhena per pronarin e markes;
- c) Daten e depozitimit ose daten prioritare te depozitimit;
- d) Numrin e regjistrimit;
- e) Daten e regjistrimit;
- f) Listen e mallrave dhe/ose te sherbimeve per te cilat eshte regjistruar marka;
- g) Ndryshimet ne emra, adresa dhe pronesi;
- h) Doreheqjen, zhvleresimin dhe shfuqizimin e markes se regjistrua;

6. Apelimet ne Bordin e Apelimt te Zyres se Patentave

Rregulli-36 Paraqitesi I kerkeses Brenda nje periudhe 3(tre) mujore nga data e njoftimit lidhur me refuzimin e kerkeses per t'u depozituar, mund te paraqese nje kerkese per apelim prane Bordit te Apelit te Zyres se Patentave. Kerkesa pranohet per shqyrtim neqoftese ajo paraqitet bashke me dokumentin qe verteton pagesen e tarifes se caktuar. Vendimi I Bordit te Apelimt lidhur me depozitimin e kerkeses eshte I formes se prere.

Rregulli-37 Paraqitesi I kerkeses Brenda nje periudhe 2 (dy) mujore nga data e njoftimit lidhur me refuzimin e kerkeses per t'u regjistruar, mund te paraqese nje kerkese per apelim prane Bordit te Apelimt te Zyres se Patentave. Kerkesa pranohet per shqyrtim neqoftese ajo paraqitet bashke me dokumentin qe verteton pagesen e tarifes se caktuar. Vendimi I Bordit te Apelimt lidhur me regjistrimin e markes mund te apelohe ne Gyrate brenda 6 (gjashte) muajve nga data e marrjes se njoftimit.

7. Zhvleresimi

Rregulli - 38 Cdo person I interesuar ka te drejte te kerkoje ne Gjykate, brenda nje periudhe 3 (tre) mujore nga data e publikimit te markes re regjistruar, zhvleresimin e saj, neqoftese sipas tij, regjistrimi ne fjale nuk I permbush kerkesat e Nenit 73 (3), 74, 75 dhe 76 te Ligjit.

Rregulli - 39 Zyra e Patentave regjistron ne Regjistrin e Markave vendimin e Gjykates per zhvleresimin e markes. Marka e zhvleresuar konsiderohet si e paqene qe nga data e regjistrimit te saj. Zyra ben publikimin e markes se zhvleresuar. Publikimi ne kete rast perfshin:

- a) perfaqesimin e markes se zhvleresuar;
- b) pronarin e markes;
- c) daten e regjistrimit te markes;
- d) numrin dhe daten e Vendimit te Gjykates

III. Rregjistrimi I ndryshimeve ne Regjistrin e Markave. Perteritja e regjistrimit.

1. Regjistrimi I ndryshimeve ne emra ose/dhe adresa

Rregulli - 40 Kerkesa per regjistrimin e ndryshimeve ne emra ose/dhe adresa behet nepermjet formularit F09/94M dhe ajo do te merret parasysh neqoftese paraqitet bashke me dokumentin qe verteton pagesen e tarifese se caktuar. Kerkesa mund te behet nga pronari I markes se regjistruar ose nga paraqitesi I kerkeses.

Rregulli - 41 Egzaminuesi ben regjistrimin e ndryshimeve ne Regjistrin e Markave dhe publikimin e tyre. Zyra I leshon pronarit te markes se regjistruar nje certifikate te re regjistrimi ne te cilen pasqyrohen ndryshimet e kerkuara.

2. Regjistrimi I ndryshimit ne pronesi

Rregulli - 42 Kerkesa per regjistrimin e ndryshimit ne pronesi behet nepermjet formularit F10/94M dhe ajo do te merret parasysh neqoftese paraqitet bashke me dokumentin qe verteton pagesen e tarifese se caktuar. Egzaminuesi regjistron ndryshimin ne Regjistrin e Markave. Zyra e Patentave ben publikimin I cili ne kete rast perfshin:

- a) perfaqesuesin e markes se regjistruar;
- b) numrin e numrin e regjistrimit;
- c) listen e mallrave dhe/ose te sherbimeve per te cilat eshte regjistruar marka;
- d) pronarin dhe pronarin e ri te markes se regjistruar.

Rregulli - 43 Kontrata e licenses dorezohet per t'u regjistruar ne Regjistrin e Markave bashke me dokumentin qe verteton pagesen e tarifese se caktuar.

3. Perteritja e regjistrimit te markes

Rregulli - 44 Kerkesa per perteritjen e regjistrimit te markes behet nepermjet formularit F12/94M I cili duhet te paraqitet bashke me dokumentin qe verteton pagesen e tarifese se caktuar Brenda periudhes

6 (gjashte) mujore para mbarimit te periudhes se regjistrimit. Kerkesa duhet te firmoset nga pronari I markes se regjistruar.

Rregulli-45 Perteritja e regjistrimit te markes shenohet nga ekzaminuesi ne Regjistrin e Markave dhe publikohet. Egzaminuesi I leshon pronarit te markes nje çertifikate te re regjistrimi e cila permban:

- a) numrin e regjistrimit te markes;
- b) daten e perteritjes se regjistrimit;
- c) emrin dhe adresen e pronarit te markes se regjistruar;
- d) listen e mallrave dhe/ose sherbimeve per te cilat kerkohet perteritja e markes se regjistruar si dhe nje tregues I klases ose I klasave sipas Klasifikimit Nderkombetar te Mallrave te Sherbimeve.

Tirane, Shtator 1994

K R Y E T A R I
Maksim KONOMI